

347.921/.95(497.7)

Prof. dr. Bashkim SELMANI<sup>1</sup>

**SISTEMI PROCEDURAL DHE PROCESI JURIDIKO-CIVIL I  
PALËVE NË PROCESET GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E  
MAQEDONISË**

**ПРОЦЕСНИОТ СИСТЕМ И ГРАЃАНСКО-ПРАВНИОТ  
ПРОЦЕС НА СТРАНКИТЕ ВО СУДСКИТЕ ПОСТАПКИ ВО  
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА**

**PROCEDURAL SYSTEM AND CIVIL JUSTICE PROCESS OF  
PARTIES IN THE PROCEEDINGS IN THE REPUBLIC OF  
MACEDONIA**

**Abstract**

Superstructure of relations that arise in a society naturally requires special attention because these relationships constitute the dynamics of its development. Adjusting on normative grounds of all this corpus would be not only impossible but also with inhibitory effects on simplicity with which progresses this relations. The justice, as basis and surface within which function the state is obliged to provide only the minimum set of rules which are sufficient to channel in the right direction of the entirety of interpersonal relations that arise and develop within the human world. With process or civil trial must be understood two phases of the process or trial, the first phase is the stage of recognition of the right from the court and the second phase is the realization of the recognized right by an act of the court, by way of execution of this act by the executor. The first phase called process or trial of recognition of the right; the second phase is the process or proceedings or enforcement

---

<sup>1</sup> Profesor universitar në Fakultetin e Drejtësisë në UT-Tetovë, në lëmin e së Drejtës Romake-Ius Romanus.

of compulsory execution. This attitude held and the European Court of Human Rights. Part of the civil procedural law that contains norms for formation and organization of courts and other bodies associated with them, constitutes what is called the Civil Procedural Law that contains norms that regulate the activity and relationships between procedural entities, is called functional civil procedural right. Both parts comprise an inseparable whole in role and function of civil procedural law.

**Keywords:**Court, charge, defendant, judicial process, procedural system, civil and legal process, the role of parties, the function of the civil procedural law, procedural subjects relations, civil rights and rights to civil and legal process, etc.

### **Hyrje**

Shikuar në prizmin e funksionimit të së drejtës procedurale në dhe atë të sistemit të drejtësisë edhe pse Maqedonia ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për themelimin e sistemit të drejtësisë, dhe përpjekje të mëtutjeshme për konsolidimin e sistemit të drejtësisë janë në proces e sipër, është kyçe në themelimin e sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të drejtësisë që të kemi angazhimin dhe përpjekjet e të gjitha palëve të interesit në shoqërinë e Maqedonisë, përfshirë edhe akademisë, për të rritur funksionimin e sistemit të drejtësisë. Qasja në drejtësi i jepet dhe garantohet të gjithë qytetarëve të Republikës me legjislacionin e saj në fuqi. Qasja në drejtësi i ofrohet dhe i garantohet të gjithë qytetarëve të Republikës sipas legjislacionit të saj në fuqi. Strukturat përkatëse për mbrojtjen e viktimave dhe integritit në gjyqësor, më herët në kuadër të Minsitrisë së Drejtësisë, janë transferuar te institucionet relevante, si Këshilli Prokurorial , Këshilli gjyqësor dhe kohëve të fundit u themelua edhe Prokuroria Speciale në Maqedoni. Qëllimi i tyre është ofrimi i të gjitha parakushteve për gjykim të drejtë dhe qasje në drejtësi, duke marrë parasysh fushëveprimin dhe kompetencat e tërë sistemit gjyqësor në Maqedoni. Legjislacioni aktual përmban shumë ligje të cilat parashohin barazinë e të gjithë qytetarëve, pa dallim etnie, gjinie, moshe apo përkatësie politike.

Nga sa u tha për kuptimin dhe strukturën e së drejtës procedurale civile, del se objekti i saj është mjaft i gjerë dhe kompleks. Prej këtej ka lindur nevoja që pjesa organizative e së drejtës procedurale civile d.m.th. pjesa e formimit dhe organizimit të gjykatave dhe të organeve

të tjera që lidhen me to, të rregullohet me ligje të veçanta, siç do ta shohim më vonë. Ky rregullim i veçantë i kësaj pjese madje ka ndikuar që edhe në fushën e shkencës të studiohet si disiplinë me vete, me emërtimin “Organizimi i drejtësisë”. Nga ana tjetër pjesa e së drejtës procedural civile që rregullon procesin ose gjykimin civil, përfshinë jo vetëm shqyrtimin e çështjeve civile, por edhe të çështjeve administrative të punës, familjare, të çështjeve me palë kundërshtare e pa palë kundërshtare. Formimi dhe organizimi i pushtetit gjyqësor nuk është qëllim më vete. Ai është kusht *sine qua non* pa të cilën nuk bëhet për ushtrimin e veprimtarisë së gjykatave dhe të organeve të tjera të lidhura me të. Ndërsa nëpërmjet veprimtarisë së gjykatave dhe të organeve që lidhen me të gjene zbatim e drejta materiale në rastet e mosmarrëveshjeve konkrete. Kështu pra procesi civil është i lidhur me të drejtën materiale. Marrëdhëniet juridike civile, të punës, shumica e marrëdhënieve administrative etj., nuk do të ishin të qëndrueshme pa garancinë e mbrojtjes së tyre nga gjykatat dhe organet e ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të tyre me karakter detyrues. Nëpërmjet ushtrimit të pushtetit gjyqësor realizohet mbrojtja e të drejtave dhe interesave të ligjshme të personave fizikë e juridike dhe njëkohësisht edhe mbrojtja e rendit shoqëror demokratik në Maqedoni. Prej këtij del përfundimi se e drejta procedurale civile ka për qëllim dhe detyrë të mbrojtë të drejtat e subjekteve që marrin pjesë në procesin gjyqësor civil nëpërmjet shqyrtimit dhe zgjidhjes së çështjeve me paanësi dhe objektivitet.<sup>2</sup>

### 1. Kuptimi historik sistemit procedural

Sipas të drejtës romake, në procesin civil roli i pretorit kufizohej vetëm në mbikëqyrjen që palët të kryejnë të gjitha formalitetet sipas rregullave. Të dyja palët thoshin fjalë ceremoniale rreptësisht të përcaktuara dhe bënin gjeste që shprehnin grindjen rituale dhe luftën rreth sendit. Në këtë ceremoni secila palë mbante në dorë një shkop të hollë *vidictor*. Pas ceremonisë pretori e ka marrë sendin nga palët dhe ia ka lënë në ruajtje një qytetari *sequester* ose njërës palë. Pastaj vinin bast kush do të fitojë dhe zgjidhnin gjyqtarin *index* në formën e kontratës që është quajtur *litis contestatio*. Gjyqtari e merrte vendimin në bazë të provave që paraqisnin palët. Kjo pra ishte një nga format e para të paraqitjes së fazave procedurale në procedurën civile që rregullonte të

---

<sup>2</sup> Bashkim Dr. Selmani “E Drejta Romake dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore”, f. 134-199. Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2013.

gjitha çështjet që kishin të bëjnë me karakter pasuror mes palëve në raste kontestuese për një të drejtë të caktuar. Në shkencën juridike për procedurën kontestimore thuhet se është rrugë apo metodë e veprimit, ose ecuri që ndjekim kur kryejmë ndonjë punë. Procedurën si tërësi e përbëjnë veprimet të cilat i kryejnë subjektet e një gjykimi në çështjen civile. Veprimet e tilla i quajmë veprime procedurale. Ato i kryejnë tri subjekte të procesit kontestimor gjyqësor- paditësi, i padituri dhe gjykata. Paditës është personi i cili paraqet kërkesën në gjykatë me qëllim që t'i jepet mbrojtje gjyqësore për të drejtën e tij subjektive civile. I paditur është personi kundër të cilit kërkohet mbrojtja gjyqësore. Gjykata është subjekti i tretë në procesin kontestimor dhe i painteresuar në objektin e gjykimit, e cila ka për detyrë të hetojë se a është e lejueshme dhe e themeltë kërkesa e paditësit për mbrojtje juridike. Varësisht nga rezultati i hetimit të përmendur, gjykata me vendimin e saj konstaton se a ka vend ose jo për dhënien e mbrojtjes juridike.<sup>3</sup>

## **2. Procedurat kontestimore dhe organet gjyqësore**

Në shkencën juridike për procedurën kontestimore thuhet se është rrugë apo metodë e veprimit, ose ecuri që ndjekim kur kryejmë ndonjë punë. Procedurën si tërësi e përbëjnë veprimet të cilat i kryejnë subjektet e një gjykimi në çështjen civile. Veprimet e tilla i quajmë veprime procedurale. Ato i kryejnë tri subjekte të procesit kontestimor gjyqësor- paditësi, i padituri dhe gjykata. Paditës është personi i cili paraqet kërkesën në gjykatë me qëllim që t'i jepet mbrojtje gjyqësore për të drejtën e tij subjektive civile. I paditur është personi kundër të cilit kërkohet mbrojtja gjyqësore. Gjykata është subjekti i tretë në procesin kontestimor dhe i painteresuar në objektin e gjykimit, e cila ka për detyrë të hetojë se a është e lejueshme dhe e themeltë kërkesa e paditësit për mbrojtje juridike.<sup>4</sup> Varësisht nga rezultati i hetimit të përmendur, gjykata me vendimin e saj konstaton se a ka vend ose jo për dhënien e mbrojtjes juridike.<sup>5</sup> Kur gjykata vjen në përfundim se ka vend për mbrojtjen e përmendur gjyqësore, ajo me vendim e pranon kërkesën e paditësit për mbrojtje juridike dhe e urdhëron të paditurin që brenda

---

<sup>3</sup> Faik, Dr. Brestovci. "E drejta procedurale civile I", faqja 11-15. Prishtinë, 2006.

<sup>4</sup> Në bazë të parimeve të Kushtetutës janë miratuar dy kategori ligjesh procedurale. Në njërin kategori hyjnë ligjet e ashtuquajtura organike, me të cilat rregullohet organizimi i gjykatave dhe i organeve të tjera shtetërore të lidhura me veprimtarinë e gjykatës.

<sup>5</sup> Faik, Dr. Brestovci "E drejta procedurale civile I", faqja 11-15. Prishtinë, 2006.

afatit të caktuar të akordojë sjelljen e tij me të drejtën subjektive të paditësit. Veprimet procedurale, duke përfshirë edhe vendimet e gjykatës, gjithmonë duhet kuptuar si tërësi dhe të lidhura ngushtë me nocionin e ecjes përpara, të zhvillimit, rrjedhjes etj. Ato, pra, bashkërisht e përbëjnë një ngjarje të vazhdueshme. Të shikuara kështu, veprimet në fjalë e përbëjnë një proces dhe ne me këtë fjalë e emërtojmë procedurën kontestimore si tërësi, që rrjedh nga fjala latine *procedure*, që ka kuptimin e ecjes përpara. Në procedurën kontestimore gjykata merr në dijeni se a ekziston e drejta subjektive e paditësit, dhe për këtë ajo quhet procedurë e vërtetimit, vendosjes, apo e kognicionit. Me Ligjin për procedure kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko- civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe. Në të shumtën e rasteve gjykata vepron sipas procedurës kontestimore, kur midis dy palëve ekziston kontesti, mosmarrëveshja. Me kontest duhet kuptuar situatën kur një person pretendon se i takon një e drejtë subjektive civile ndaj personit tjetër, e ky e mohon ekzistimin e saj, apo nga ndonjë fakt tjetër e mohon detyrimin e tij që të sillet në mënyrën e caktuar. Situatën kontestuese materialo-juridike e zgjedhë organi kompetent, zakonisht gjykata shtetërore, duke dhënë vendim merititor, gjithmonë sipas kërkesës së palës.

### **3. Procedurën si tërësi e përbëjnë veprimet të cilat i kryejnë subjektet**

Procedurën si tërësi e përbëjnë veprimet të cilat i kryejnë subjektet e një gjykimi në çështjen civile, këto veprime i quajmë veprime procedurale. Veprimet procedurale i kryejnë tri subjekte kryesore të procesit konkret gjyqësor, paditësi, i padituri dhe gjykata. Paditës është personi i cili paraqet kërkesë në gjykatë me qëllim që t'i jepet mbrojtje gjyqësore për të drejtën e tij subjektive civile. I paditur është personi kundër të cilit kërkohet mbrojtja gjyqësore. Gjukata është subjekti i tretë në procesin kontestimor dhe i pa interesuar në objektin e gjykimit. Kontesti dhe procesi kontestimor janë dy nocione të ndryshme. I pari ka të bëjë me gjendjen e krijuar në raportin material- juridik, kurse nocioni i dytë ka të bëjë me procedurën gjyqësore në të cilën gjendja e tillë gjen zgjedhje. Për emërtimin e kontestit si nocion mund të përdoret edhe termi konflikt.<sup>6</sup>Në ushtrimin e funksionit gjyqësor gjykatat janë të

---

<sup>6</sup> Po aty. 23-25.

pavarura dhe gjykojnë në bazë të kushtetutës, ligjit dhe akteve të përgjithshme të tjera. Në sistemet bashkëkohore juridike, ku bënë pjesë edhe sistemi ynë, burim të së drejtës, parimisht, janë vetëm rregullat e shkruara juridike. Burim i parë komplet i procedurës kontestimore është ligji mbi procedurën kontestimore. Për procedurën me rëndësi është edhe Ligji mbi zgjidhjen e konflikteve të ligjeve me dispozitat e shteteve të tjera në raportet e caktuara i vitit 1982, sepse me dispozitat e tyre është rregulluar kompetenca ndërkombëtare e gjykatave tona për zgjidhjen e çështjeve me element ndërkombëtar si dhe ajo e njohjes dhe e ekzekutimeve të vendimeve të gjykatave të huaja. Me rëndësi për procedurën kontestimore janë dispozitat e Ligjit mbi ujdinë e detyrueshme dhe falimentimin, ato të Ligjit mbi ndërtesat dhe lokalet afariste me të cilat është rregulluar procedura e dhënies së urdhëresës për zbrazjen dhe dorëzimin e lokaleve të punës. E drejta materiale dhe ajo procedurale kanë lëndë të ndryshme, por në procesin kontestimor janë ngushtësisht të lidhura. Shpeshherë zbatimi i së drejtës procedurale në gjykimin konkret kushtëzohet me zbatimin e së drejtës materiale. Kur gjykatës i paraqitet padia, ajo së pari konstaton se a është ajo e rregullt, e mandej se ku bën pjesë çështja juridike për të cilën kërkohet mbrojtja gjyqësore, në kompetencën e gjykatës shtetërore, në atë të gjykatës joshitetërore, apo në atë të organit administrativë. Përgjigjen lidhur me kompetencën gjykata e jep në bazë të asaj se në cilën lëmë juridike bënë pjesë raporti juridik nga i cili ka lindur kontesti midis paditësit dhe të paditurit. Për gjykimin e disa çështjeve juridike kompetenca lëndore dhe tokësore me ligj është caktuar varësisht nga natyra materialo-juridike e vetë të së drejtës subjektive kontestuese.

#### **4. Prezumimet procedural**

Konstatimin e disa prezumimeve procedurale të tjera gjykata e bënë në bazë të normës materiale, p.sh. zotësia e paditësit dhe të paditurit për të qenë palë ndërgjyqëse, si dhe zotësia e tyre për të kryer veprime procedurale në gjykim, vërtetohet nga gjykata në bazë të rregullave materialo- juridike për zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar të subjekteve të së drejtës.<sup>7</sup> E drejta Procedurale Civile, kryen një mision tepër të rëndësishëm në përgatitjen dhe kualifikimin e personave që do të japin drejtësinë. Ajo ka për qëllim që në veprimtarinë gjyqësore të

---

<sup>7</sup> Selmani, Dr. Bashkim, "E Drejta Romake dhe ndikimi saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore", f. 446-449. Botues: Universiteti Shtetëror i Tetovës. Tetovë, 2013.

sigurohet zgjidhja e drejtë e pa vonesë e mosmarrëveshjeve në fushën civile, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, si kusht i domosdoshëm për dhënien e drejtësisë në një shtet të së drejtës. Procedura Civile përbën tërësinë e normave juridike që rregullojnë e dispiplinojnë veprimtarinë e gjykatave në dhënien e drejtësisë e në zbatimin e saj, procedurën në të cilën mbështetet e zhvillohet kjo veprimtari, si dhe marrëdhëniet e lindura gjatë saj në shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile. Këto raporte që krijohen ndërmjet gjykatës nga njëra anë dhe pjesëmarrësve në gjykim nga ana tjetër, sjellin të drejta dhe detyrime që rregullohen nga normat procedurale dhe përbëjnë përmbajtjen e marrëdhënies juridike- procedurale civile. Rolin kryesor në këto raporte e luan gjykata, si organi i vetëm për dhënien e drejtësisë. Gjatë gjykimit të një çështjeje civile krijohen raporte të ndryshme midis gjykatës si organ shtetëror dhe subjekteve të tjera të procesit gjyqësor civil. Me termin Gjykatë do të kuptojmë jo vetëm Gjykatën Themelore, por edhe atë të Apelit, dhe Supreme.<sup>8</sup>

Subjekte të tjerë të këtyre marrëdhënieve janë: prokurori, paditësi, i padituri dhe personi i tretë. Subjekt i marrëdhënies juridike-procedurale civile konsiderohet edhe personi i interesuar. Personi i interesuar është kryesisht një person juridik që thirret nga gjykata, kur konstatohet që zgjidhja e çështjes prek interesat e tij, p.sh. sigurimet shoqërore në gjykimet lidhur me moshën, vjetërsinë në punë etj. Ndërsa vlen të theksohet se në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ky person nuk konsiderohet subjekt i kësaj marrëdhënie, por thjesht si pjesëmarrës i mundshëm në disa gjykime për vërtetimin e fakteve juridike. Në literaturën juridike është shfaqur pikëpamja se si subjekt i marrëdhënieve juridike procedurale civile janë edhe avokatët, dëshmitaret, ekspertët, përkthyesi të cilët luajnë rol ndihmese në procesin gjyqësor civil.<sup>9</sup> Duke u nisur nga fakti se qenësia e tyre në proces nuk është kusht për zhvillimin e tij, por ajo varet nga lloji i çështjes në gjykim, themi se ato nuk janë subjekt të kësaj marrëdhënie, por faktorë ndihmës në ecurinë e procesit gjyqësor civil.<sup>10</sup>

---

<sup>8</sup> Vasil, J. "Procedura civile" f. 234-256.

<sup>9</sup> Vasil, J. "Procedura civile".

<sup>10</sup> Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë është i brengosur se dështimi i gjykatave për t'i trajtuar në mënyrë të duhur parashtrësat e palëve gjatë procedurës civile në gjykatat e Kosovës mund ta shkelë kornizën ligjore të Kosovës dhe të sjellë deri te shkeljet e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Kur gjykata vjen në përfundim se ka vend për mbrojtjen e përmendur gjyqësore, ajo me vendim e pranon kërkesën e paditësit për mbrojtje juridike dhe e urdhëron të paditurin që brenda afatit të caktuar të akordojë sjelljen e tij me të drejtën subjektive të paditësit. Veprimet procedurale, duke përfshirë edhe vendimet e gjykatës, gjithmonë duhet kuptuar si tërësi dhe të lidhura ngushtë me nocionin e ecjes përpara, të zhvillimit, rrjedhjes etj. Ato, pra, bashkërisht e përbëjnë një ngjarje të vazhdueshme. Të shikuara kështu, veprimet në fjalë e përbëjnë një proces dhe ne me këtë fjalë e emërtojmë procedurën kontestimore si tërësi, që rrjedh nga fjala latine *procedure*, që ka kuptimin e ecjes përpara.<sup>11</sup> Në procedurën kontestimore gjykata merr në dijeni se a ekziston e drejta subjektive e paditësit, dhe për këtë ajo quhet procedurë e vërtetimit, vendosjes, apo e kognicionit.<sup>12</sup> Subjektet e së drejtës civile mund të ushtrojnë lirisht të drejtat e tyre, mjafton që të jenë në pajtim me ligjin, duke lidhur kontrata ose duke kryer veprime të tjera juridike. Zakonisht të drejtat subjektive respektohen nga subjektet e së drejtës, duke u përmbajtur nga shkelja e tyre, si p.sh. mospengim i pronarit të sendit në ushtrimin e targave të tij të pronësisë. Megjithatë nuk janë të pakta rastet që subjektet e së drejtës, persona fizikë e juridike shkelin të drejtat subjektive të bartësve të tyre.<sup>13</sup>

### **5. Roli i Subjektit të së drejtës subjektive të shkelur**

Në raste të tilla subjekti i së drejtës subjektive të shkelur detyrohet të kërkojë mbrojtjen nëpërmjet gjykatës. Zakonisht në procesin gjyqësor marrin pjesë dy palë kundërshtarë për shkak të mosmarrëveshjes që kanë midis tyre. Njëra palë paditësi pretendon se i është shkelur një e drejtë subjektive nga pala tjetër, ndërsa kjo e fundit i padituri e mohon qenien e së drejtës së pretenduar për një arsye ose tjetër. Ky quhet procesi gjyqësor me palë kundërshtarë, *juridictio contentiosa*. Proceset civile me palë kundërshtarë përbëjnë pjesën dërrmuese të çështjeve civile. Por krahas tyre gjykata shqyrton edhe çështje civile pa palë kundërshtarë, të cilat janë shumë më të pakta. Në këto gjykime merr pjesë vetëm kërkuesi dhe kanë për qëllim vërtetimin e një fakti, p.sh. dëshmia e trashëgimisë, vërtetimi i faktit të identitetit të një personi, ose

---

<sup>11</sup> Po aty f. 11-15.

<sup>12</sup> Sipas Ombudspersonit, të Republikës së Maqedonisë përafërsisht 39% e ankesave të pranuar përgjatë vitit 2013 janë drejtuar për në gjykatë.

<sup>13</sup> L.Omari, Parime dhe institucione të së drejtës publike, Tiranë 1993, f.167-269.



ndryshimin e pozitës juridike të një personi, siç është heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar etj.

Si në legjislacionin tonë procedural të mëparshëm ashtu edhe në legjislacionin aktual në fuqi, nuk bëhet dallimi midis procesit gjyqësor me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare, me të drejtë, për arsye se vetë procedurat e gjykimit pa palë kundërshtare për çështje të ndryshme janë të ndryshme. Me një fjalë nuk mund të vendosen rregulla të përbashkëta për çështjet e ndryshme pa palë kundërshtare. Prandaj këto grupohen në pjesën me titull gjykime të posaçme. Llojet e ndryshme të çështjeve janë rregulluar me dispozita të veçanta. Gjykatat organizohen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre si organe të pavarura të pushtetit gjyqësor, në pajtim me Kushtetutën dhe në bazë të ligjit e akteve normative të tjera. Kushtetuta është baza themelore me të cilën vendosen parimet e rendit shoqëror e shtetëror dhe të organizimit të pushtetit shtetëror. Prej saj përcaktohet përmbajtja e ligjeve të tjera. Prandaj asnjë ligj nuk mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën. Për këto arsye, ashtu si për degët e tjera të së drejtës edhe për të drejtën procedurale civile, Kushtetuta është burimi kryesor. Në dispozitat e saj janë sanksionuar parime kryesore të organizimit dhe të veprimtarisë së gjykatave dhe të organeve të tjera të lidhura me ato çështje procedural. <sup>14</sup>

## **6. Të drejtat e qytetarëve në Gjykatë**

Të drejtat e qytetarëve në Gjykatë janë të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë. Në procesin gjyqësor civil, e drejta themelore është e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës me padi. Me anë të padisë kërkohet njohja e një të drejte ose mbrojtja e një të drejte që është mohuar ose cenuar nga një person tjetër. Palët në një proces gjyqësor

---

<sup>14</sup> Gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, si rezultat i procesit të rregullt dhe të drejtë, është një çështje shumë e rëndësishme dhe mjaft e trajtuar. Një çështje e tillë, në kuadrin e shtetit ligjor, ka gjetur shprehje dhe në Kushtetutë e Republikës së Maqedonisë, ku përcaktohet se “e drejta përbën bazën e shtetit ligjor”. Të tilla parashikime synojnë në vetvete që jo vetëm të garantojnë një veprimtari ligjore normale të shtetit, por dhe në ato raste kur vërehen shkelje apo mos respektim i të drejtës, organet e specializuara të garantojnë nëpërmjet një procesi të rregullt dhe të drejtë, dhënien e drejtësisë së munguar apo të mohuar, gjithmonë në respektim të parimeve bazë mbi të cilat drejtohet apo bazohet veprimtaria e gjykatave në procesin gjyqësor, si organe të specializuara dhe të ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për të dhënë drejtësi.

civil kanë të drejtën për të kërkuar përjashtimin e njërit ose të të gjithë anëtarëve të trupit gjykues, në rastet kur ata kanë interes në çështjen që shqyrtohet ose për mosmarrëveshje të tjera që kanë lidhje me çështjen në gjykim;

➤ kur gjyqtari ose bashkëshorti i tij është i afërm i njëres prej palëve në proces;

➤ kur gjyqtari paraprakisht ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim si dhe

➤ për çdo lloj arsye tjetër e cila krijon bindjen se gjyqtari nuk do të jetë i paanshëm.

Çdo person ka të drejtë të ndërhyjë në gjykimin që është duke u zhvilluar midis personave të tjerë, në rast se ai pretendon për vete të drejtën ose sendin për të cilin zhvillohet gjykimi. Po ashtu ai mund të ndërhyjë edhe kur ka interes për të mbështetur njëren ose tjetren palë me të cilën bashkohet në gjykim.

## **7. Të drejtat për të ndërhyjë në gjykimin**

Secila prej palëve në gjykimin civil ka të drejtë të thërrasë për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes, personin që mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohej një garanci që lidhet me përfundimin e çështjes. Secila nga palët në proces ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës që të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje që të paraqesë në gjykim një dokument ose send i cili konsiderohet i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes dhe që nuk mund të sigurohet nga pala që bën pretendimin. Paditësi ka të drejtë që në çdo fazë të gjykimit të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast Gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Paditësi ka të drejtën që t'i kërkojë Gjykatës marrjen e masave për sigurimin e padisë në ato raste kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Po ashtu, secila nga palët ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës të marrë masa për sigurimin e një prove e cila rrezikon të zhduket ose marrja e së cilës në të ardhmen mund të bëhet e pamundur ose e vështirë. Kjo në rastet kur prova ka rëndësi themelore për zgjidhjen e çështjes. Palët në gjykimin civil kanë të drejtë të paraqesin provat të cilat provojnë pretendimet përkatëse. Këtu përfshihet: thirrja e dëshmitarëve, paraqitja e provave shkresore etj. Personat që nuk dinë gjuhën zyrtare kanë të drejtë të përdorin në gjykim gjuhën e

tyre dhe të njihen me provat dhe me gjithë zhvillimin e gjykimit nëpërmjet përkthyesit.

Çdo qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në një proces gjyqësor civil, me përjashtim të rasteve kur Gjykata vendos që gjykimi të bëhet me dyer të mbyllura për shkak të ruajtjes së një sekreti shtetëror dhe rendit publik; përmendjes së rrethanave të jetës intime të pjesëmarrësve në gjykim apo të ruajtjes së sekretit tregtar apo shpikjeve. Një e drejtë tjetër themelore e pjesëmarrësve në gjykim është e drejta për t'u ankuar ndaj vendimeve dhe urdhrave të Gjykatës. Personat që procedohen në kundërshtim me ligjin ose dënohen pa të drejtë kanë të drejtë të kërkojnë që tu kthehen të drejtat dhe të shpërblehen për dëmin e pësuar. Secila nga palët në procesin gjyqësor penal ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e njërit ose të të gjithë anëtarëve të trupit gjykues në rastet kur ato kanë interes për çështjen, kur është kujdestar përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit, kur ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit, kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit të tij është cenuar apo dëmtuar nga vepra penale si dhe kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie.

Deri në datën e caktuar për gjykim palët mbrojtësit dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të shikojnë sendet e sekuestruara të shqyrtojnë në sekretari aktet dhe dokumentet e mbledhura në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor si dhe të nxjerrin kopje të tyre. I pandehuri edhe kur është me masë sigurimi izoluese ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkakut tjetër ka të drejtë të merret në pyetje i lirë. I pandehuri ka të drejtë të mos i përgjigjet pyetjeve të bëra nga ana e Gjykatës ose nga ana e prokurorit, po kështu ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata marrjen e provave që janë në favor të tij. I pandehuri i mitur ka të drejtë të kërkojë ndihmë juridike dhe psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

Në procesin penal i pandehuri ka të drejtë të kërkojë ose të japë pëlqimin që gjykimi të zhvillohet në mungesë të tij. Gjatë procesit gjyqësor penal palët kanë të drejtë të kërkojnë pyetjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve, t'u drejtojnë atyre pyetje me qëllim për të vërtetuar fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Para fillimit të procesit penal i pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm kanë të drejtë të kërkojnë gjykim të shkurtuar pra që çështja të përfundohet derisa të mos ketë përfunduar shqyrtimi gjyqësor në gjendjen që janë aktet në rast se kërkesa pranohet dhe pranohet fajësia gjykata ul dënimin me një të tretën dhe dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me njëzet e

pesë vjet burgim. Prokurori ka të drejtë të kërkojë gjykim të drejtpërdrejtë kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë ose kur gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit ai e ka pohuar dhe fajësia e tij është e qartë.

Çdo person që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrënë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit. Dëshmitari në një proces gjyqësor penal ka të drejtë të mos dëshmojë për fakte nga të cilat mund të lindë përgjegjësia penale për të. Në një proces gjyqësor penal kanë të drejtë të përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar këta persona: të afërmit e të pandehurit, bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore, bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri, ai që bashkëjeton me të pandehurin ose ka bashkëjetuar me të, ai që është i lidhur me të pandehurin në marrëdhënie birësimi gjithashtu në një proces gjyqësor penal kanë të drejtë të mos dëshmojnë për shkak të ruajtjes së sekretit profesional këta persona, përfaqësuesit e besimeve fetare statutet e të cilëve nuk janë në kundërshtim me rendin juridik shqiptar, avokatët, përfaqësuesit ligjor dhe noterët, mjekët, kirurgët, farmacistët, obstetrët dhe kushdo që ushtron një profesion shëndetësor si dhe ata të cilët ushtrojnë profesione të tjera të cilëve ligji u njeh të drejtën të mos dëshmojnë për ato që lidhen me sekretin profesional.

Një nga të drejtat themelore të pjesëmarrësve në procesin gjyqësor penal ashtu si edhe në procesin gjyqësor civil është e drejta e tyre për t'u ankuar ndaj vendimeve dhe urdhrave të Gjykatës.

Gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, si rezultat i procesit të rregullt dhe të drejtë, është një çështje shumë e rëndësishme dhe mjaft e trajtuar. Një çështje e tillë, në kuadrin e shtetit ligjor, ka gjetur shprehje dhe në Kushtetutë e Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se “e drejta përbën bazën e shtetit ligjor”. Të tilla parashikime synojnë në vetvete që jo vetëm të garantojnë një veprimtari ligjore normale të shtetit, por dhe në ato raste kur vërehen shkelje apo mos respektim i të drejtës, organet e specializuara të garantojnë nëpërmjet një procesi të rregullt dhe të drejtë, dhënien e drejtësisë së munguar apo të mohuar, gjithmonë në respektim të parimeve bazë mbi të cilat drejtohet apo bazohet veprimtaria e gjykatave në procesin gjyqësor, si organe të specializuara dhe të ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për të dhënë drejtësi. Të tilla parime bazë, mbi të cilat duhet të mbështetet gjykata gjatë procesit civil, burojnë qoftë drejtpërdrejtë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, çka do të thotë se janë të parashikuara në dispozitat e saj, qoftë dhe jo

në mënyrë të drejtpërdrejtë nga interpretimi i dispozitave të saj, apo që nuk burojnë nga Kushtetuta, pra, që janë parashikuar në ligje të veçanta, të procedurës Civile, dhe mosrespektimi i tyre, konsiderohet si një shkelje e rëndë e parimeve kushtetuese dhe e shtetit të së drejtës. Çështja e garancive në procesin civil dhe parashikimet kushtetuese të këtyre garancive, janë trajtuar edhe më parë.<sup>15</sup>

Një garanci e tillë buron drejt për drejtë nga Kushtetuta, duke siguruar drejtësinë e procesit, si dhe duke garantuar palët për paanshmërinë e gjyqtarit që shqyrton çështjen në pozicionin e tij si arbitër, pa u lidhur dhe u ndikuar nga palët. Parashikime të tilla kushtetuese, janë në përputhje të plotë dhe me përcaktimet që bëhen në nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (e njohur si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut), ku theksohet paanshmëria dhe pavarësia e gjykatave në vendimmarrje. Pavarësisht garancive kushtetuese dhe ligjore, në praktikën tonë janë hasur raste të mungesës së respektimit të tyre. Vendimet gjyqësore, janë marrë, në disa raste, në mungesë të plotë të respektimit të tilla garancive, duke ndikuar drejt për drejtë në ligjshmërinë dhe drejtësinë e procesit gjyqësor, por që kanë gjetur mundësi “korrigjimi” në Gjykatën Kushtetuese, e cila ka përcaktuar më së miri se, vendime të tilla gjyqësore janë dhënë në kundërshtim me parimet kryesore kushtetuese, çfarë sjell edhe antikushtetueshmërinë e tyre.

Debati gjyqësor ose kontradiktoriteti në procesin civil *audiatur et altera pars* që në një kuptim do të thotë “le të dëgjohet edhe pala tjetër”, përbën një prej parimeve themelor në proces, ku palëve duhet t’u jepet mundësia për t’u dëgjuar mbi pretendimet e tyre, e cila është në përputhje me parashikimin Kushtetues. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet”. Pra, kontradiktoriteti është zhvillimi i gjykimit në mënyrë kontradiktore, që nënkupton se: “...ai që ngre një padi i parashtron gjykatës faktet mbi të cilat ai bazon kërkimet e tij dhe paraqit dhe prova për të vërtetuar këto fakte kurse ana kundërshtare ka dhe ajo të drejtë të kundërshtojë këto fakte dhe të paraqit prova kundër këtyre fakteve ose të parashtrijë pretendimet që kundërshtojnë faktet e parashtriuara nga ana tjetër”.

Asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim. Gjithashtu, shprehje në mënyrë të drejtë për drejtë, një parim i

---

<sup>15</sup> Parimi themelore i organizimit shtetëror është ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor”, “barazinë përpara ligjit” apo ”pavarësinë e gjykatave.

tillë, “Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoriteti”. Mos parashikimi në Kushtetutë, në mënyrë të drejtë për drejtë, nuk nënkupton rëndësi më të vogël në raport me parimet e tjera, pasi një parim i tillë, ka lidhje të drejt për drejtë me parimin e një gjykimi të drejtë ligjor dhe mosrespektimi i tij, do të sillte një proces jo të rregullt, pra antikushtetues. Në një interpretim të tillë, ky parim mund të konsiderohet, se buron në mënyrë jo të drejt për drejt nga Kushtetuta, por, pavarësisht se nuk përbën një garanci të drejt për drejtë kushtetuese, respektimi i tij është domosdoshmëri, pasi, çdo vendim që do të merrej në mungesë të tij, do të konsiderohej në kundërshtim me përcaktimet dhe parimet e tjera kushtetuese. Në këtë frymë, Gjykata Kushtetuese në vendimet e saja ka përcaktuar që gjykata ka detyrimin për të njoftuar palët në proces, për ti krijuar mundësinë që ato të dëgjohen dhe të mbrohen me mjetet ligjore të parashikuara, gjithmonë në kuadër të respektimit të parimit të kontradiktoritetit, si garanci për një proces të rregullt ligjor.

E drejta e disponimit, apo siç njihet ndryshe parimi i disponimit të palëve, që do të thotë “...mundësia që ka çdo person që të përdorë objektin e padisë d.m.th. të drejtën materiale si dhe mjetet gjyqësore d.m.th. rrugën gjyqësore për ruajtje apo mbrojtje një të drejtë... që nuk duhet të vijë me të drejtën e ligjshme të personave të tjerë...”, nuk është një parim që rrjedh drejt për drejtë nga Kushtetuta jonë. Nuk ka një përcaktim konkret mbi të drejtën e disponimit, në dispozitat kushtetuese. Megjithatë, pavarësisht kësaj mungese, nuk nënkuptohet që një parim i tillë nuk ka mbështetje apo parashikim ligjor. Kjo, nxirret nga konteksti dhe interpretimi i dispozitave Kushtetuese, si dhe me një referim në dispozitat e Procedurës Civile, dispozita e të cilit duhet të jenë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe jo në kundërshtim me to. Kështu, ndër parashikimet e tjera, në kuadër të së drejtës së disponimit të palëve, mund të përmendim. Palët janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim. Një mundësi e tillë shihet edhe në dispozita të tjera ligjore, që nënkupton mundësinë që kanë palët në procesin gjyqësor, pa u kufizuar, në të drejtën e tyre për tu mbrojtur në mënyrën që ata e shohin më të arsyeshme, apo të drejtën e për të hequr dorë nga pretendimet e ngritura, të pakësojnë objektin e padisë, të ndryshojnë bazën ligjore, kjo në kuadër të drejtave së tyre në këtë proces, por që gjithmonë duhet të jetë jo në kundërshtim me të drejtën

e ligjshme të personave të tjerë.<sup>16</sup> Ashtu siç u theksua më sipër, garantimi i një procesi të rregullt ligjor është dhe duhet të jetë detyrimi dhe pikësynimi kryesor i gjykatave tona. Kështu, një detyrim i tillë, që buron nga Kushtetata, ku fiksohet garancia apo e drejta e personit për një proces të drejtë “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë”.

**...çdo person ka të drejtën që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht”**

Kjo nënkupton detyrimin e zbatimit të të gjitha parimeve apo garancive, që sigurojnë një proces të rregullt ligjor, pasi është e lidhur ngushtësisht dhe me parimet e tjera, mbi të cilat bazohet procedimi civil, që shërbejnë si gurë themeli për dhënien e drejtësisë, nga ana e gjykatave tona.

Gjykimi publik i çështjeve ka një rëndësie të madhe pasi, nëpërmjet zhvillimit të procesit me dyer të hapur, rritet sensibiliteti i shtetasve në raport me të drejtën. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është garancia, që jep zhvillimi me dyer të hapur i procesit, në raport me gjykime të rregullta dhe vendimmarrje të drejtë nga ana e gjykatës, duke iu referuar vetëm përcaktimeve kushtetuese dhe ligjeve në fuqi. Pavarësisht një detyrimi të tillë, janë parashikuar gjithashtu dhe raste të lejimit të gjykimit me dyer të mbyllura, por gjithmonë për raste krejtësisht të kufizuara dhe të mirë përcaktuara. Kështu, përcaktohet që, të pranishëm mund të jenë vetëm qytetarët e moshës madhore, dhe kjo me synimin e vetëm, të mbrojtjes së personave nën 16 vjeç për shkak të zhvillimit të tyre. Vendimet duhet të jepen publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet në *shkallë që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë*”. Detyrimi i të bërit publik të vendimit, pavarësisht procedimit me dyer të mbyllura apo jo, shihet si garanci për rritjen sensibilitetit të qytetarëve në raport me të drejtën dhe për gjykime apo vendimmarrje të drejtë nga ana e gjykatës.

---

<sup>16</sup> Praktika ka treguar se shkelje ligjore të kësaj natyre, në proceset gjyqësore, ka pasur, çfarë ka detyruar Gjykatën Kushtetuese, për çështjet që i janë paraqitur për shqyrtim, të sjell në vëmendje të gjykatave detyrimin për të respektuar një parim të tillë. Ajo në vendimet e saj ka qëndruar konsekuente, duke përcaktuar dhe ritheksuar detyrimin e respektimit të parimeve bazë të procedimit nga ana e gjykatave, për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

## 8. Barazia mes palëve dhe barazia e mjeteve të mbrojtjes

Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes, duhet që t'u japë mundësinë palëve, që të mbrohen me mjete të barabarta, për aq sa është e mundur, duke shmangur favorizimin e njëres apo tjetrës, pra, trajtimin në pozita dhe mënyrë të barabartë të tyre. Duke përcaktuar detyrimin e gjykatës, që në kuadër të ekuilibrit të procesit, të trajtojë palët në mënyrë të barabartë. Kështu, Ekuilibri në proces, pranimi i barazisë së armëve duke mos lejuar avantazh të konsiderueshëm të njëres palë ndaj tjetrës, janë kërkesa të cilat janë pranuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut si elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me paanshmërinë e në analizë të fundit me procesin e rregullt ligjor. Kjo do të thotë që gjykata në gjykimin e saj është e detyruar të marrë në shqyrtim provat e palëve në proces, pa anashkaluar apo shmangur vlerësimin e provave të njëres apo tjetrës, duke synuar kështu në respektimin edhe të një garancie tjetër kushtetuese e përcaktuara me ligj. Pra, respektimi nga ana e gjykatës, i parimit të barazisë mes palëve, gjatë shqyrtimit gjyqësor, është një element garantues për këto të fundit, për vendime të drejta dhe të bazuara në ligj, duke rritur besueshmërinë ndaj këtij pushteti. Gjykimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm, është shumë i rëndësishëm dhe përbën një garanci kushtetuese dhe që buron drejt për drejtë nga ajo. Gjykata duhet të shprehet... brenda një afati të arsyeshëm. Të tilla përcaktime, janë në përputhje me ato që bëhen në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, më konkretisht në nenin 6 të saj „çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet... brenda një afati të arsyeshëm”, gjë e cila, në disa raste, ka shkakuar prishjen e vendimeve gjyqësore, që në kontekstin e përgjithshëm kanë rezultuar në kundërshtim me këtë parim. Për sa i përket përcaktimit apo të arsyetimit, për kohën e arsyeshme të gjykimit, apo se kur një vendim duhet të konsiderohet në kundërshtim ose jo të këtij parimi, duhet tu referohesh disa elementëve të rëndësishëm tregues, si: “...

- kompleksiteti i çështjes.
- interesi që mund t'i jetë cenuar aplikuesit.
- mënyra e shqyrtimit të çështjes nga autoriteti gjyqësor.
- sjellja e vetë aplikuesit...”.

Sa rezulton më sipër, përcaktimi i kohës së arsyeshme të gjykimit, është produkt i trajtimit dhe marrjes në konsideratë të një kompleksiteti faktorësh, që ndikojnë drejt për drejt në ecurinë e procesit gjyqësor, pra në kohën e nevojshme për një vendim gjyqësor të drejtë dhe në përputhje me të gjitha garancitë kushtetuese ose jo, për një proces të



drejtë dhe ligjor. Garancitë e mësipërme, përbëjnë bazën kryesore, mbi të cilat bazohet dhe zhvillohet procesi civil, por që nuk do të thotë se janë të vetmit elementë garantues të procesit të rregullt ligjor. Shkenca e së drejtës ka evidentuar, gjithmonë kjo, referuar dhe ndryshimit apo zhvillimit të marrëdhënieve në qarkullimin civil, edhe një sërë elementësh të tjerë që sigurojnë dhe që ndikojnë në ligjshmërinë e procesit. Ato, nuk mund të shihen të ndara me parimet apo garancitë e trajtuara më sipër, pasi qëndrojnë të lidhura ngushtë, si elementë të përbashkët të një qëllimi, garantimin e një procesi gjyqësor në përputhje të plotë me parimet kushtetuese.

*“Në një gjykim për vërtetësi apo pavërtetësi dokumenti gjykata duhet të shqyrtojë me kujdes çështjen, t’i japë përgjigje pretendimeve të palëve në proces dhe nëse provat e paraqitura janë të falsifikuara ajo duhet t’i deklarojë si të tilla”*

## **PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA ANKETIMI ME PALË DHE QYTETAR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PERENDIMORE**



### **1. Pikëpamjet themelore mbi fazën përfundimtare**

Sistemi procedural dhe procesi juridiko-civile i palëve në proceset gjyqësore në Republikën e Maqedonisë (2010-2015), përmban disa të dhëna të vërtetuara në hipotezat e parashtruar në pjesën metodologjike të këtij punimi shkencor. Mbështetur në anketimin e bërë 100 qytetarë të grupmoshave dhe qyteteve të ndryshme, në analizimin e të dhënave në bazë rezultateve anketuese i nxorëm këto konstatime dhe konkluzione në lidhje me pozitën e palëve në aspektin juridiko-civil ,


në këtë këndvështrim mendojmë se tek ne duhet të bëhet më shumë në informimin e qytetarëve se cila është pozita e tyre në procesin kontestimor apo të mosmarrëveshjeve juridiko-civile por edhe ato administrative në përgjithësi. Po ashtu, në bazë të dhënave nga terreni është me rëndësi të veçantë edhe njohuritë elementare juridike në lidhje me ligjin dhe dispozitat ligjore që po aplikohen në rregullimin e kësaj çështjeje juridiko-pronësore apo atë të drejtave dhe detyrimeve mes palëve në një mosmarrëveshje të caktuar juridike me karakter pasuror apo jo pasuror. Me përpunimin më detal të këtyre të dhënave do të konkludohet në mënyrë të detajuar për pozitën, gjendjen reale dhe sfidat për shoqërinë shqiptare në Republikën e Maqedonisë në krahasim me sistemet e së drejtës bashkëkohore. Qytetarët gjatë bashkëbisedimit jashtë protokollit të pyetjeve tona, kanë shprehur interesimin dhe gatishmërinë e tyre që të informohen edhe më shumë në lidhje me pozitën e tyre në procesin kontestimor, bazuar në ligjet e aplikueshme në Republikën Maqedonisë, duke na parashtruar edhe pyetje të shumta se si mund t'u ofrojmë ndihmë juridike.<sup>17</sup> Mbështetur në parimet bazë të të dhënave nga terreni si dhe në metodologjinë e punimit shkencor, kemi aplikuar edhe pyetësorin anketues me 10 pyetje të paraqitura në anketë në fushën e studimit të lartpërmendur, që është edhe objekt studimi i këtij punimi shkencor siç është sistemi dhe procesi juridiko-civil i palëve në një proces gjyqësor në të drejtën private të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë dhe pozita e qytetarëve shqiptar gjatë pesë viteve të fundit. Anketa është e përbërë nga pyetjet në të cilën janë paraparë dy mundësi të përgjigjeve si dhe mendimet plotësuese me anë të deklaratës.

---

<sup>17</sup> Parashtrimi i pyetjeve nga ana e qytetarëve konsiderojmë se është i mirë se ardhur, sepse vlerësojmë se të njëjtit kanë zgjuar interesim në lidhje me këtë çështje juridiko-civile, apo vet sistemin e së drejtës në Republikën Maqedonisë pikërisht mendimi i qytetarëve shqiptar sepse drejtësinë nuk e gjejnë dot në këtë shtet.

## PYETËSORI ANKETUES


## 1. A dini se çfarë nënkuptojmë me sistemin e së drejtës?



Grafikoni Nr.1.

Në pyetjen e parë të pyetësorit të anketuarit u shprehën të ndarë për sa i përket qëndrimit të tyre. Pasi që jo të gjithë të anketuarit kishin njohuri lidhur me sistemin e së drejtës në Republikën e Maqedonisë si dhe njohuri të tjera me të drejtat ligjore. Në këtë pyetje me Po u përgjigjën 26%. Ndërsa me Jo u përgjigjën 69.5%. Që do të thotë se shumica e të anketuarve u shprehen se nuk kanë njohuri lidhur me sistemin e së drejtës në Republikën e Maqedonisë. Në bazë të kësaj pyetje shumë qytetarë nuk ndanin mendime të njëjta për sa i përket funksionimit të sistemit të së drejtës gjyqësore në Republikën e Maqedonisë.


## 2. A keni njohuri lidhur me mbrojtjen ligjore të drejtave private?



Grafikon Nr.2

Në pyetjen e dytë të anketuarit u përgjigjen në mënyrë pozitive dhe me plot vendosmëri dhe atë ; Me Po u përgjigjën 71.3. % e të anketuarve. Në grupin e dytë me Jo u përgjigjën 19.4 %. Çka do të thotë se shumica e tyre kishe njohuri për të drejtat e tyre private dhe çfarë nënkuptojmë me të drejtat e private dhe si mbrohen këto të drejta me legjislacionin e Republikën e Maqedonisë.

### 3. A jeni të kënaqur me gjyqësorin në Republikën e Maqedonisë?




Grafikon Nr.3

Në këtë pyetje të anketuarit kishin mendime të ndryshme dhe u përgjigjën në këtë mënyrë: në kategorinë e grupit të parë një pjesë e qytetarëve u përgjigjën pozitivisht dhe atë me 39.1%, ndërsa në grupin e dytë të të anketuarve kishin mendime të ndryshme negative dhe një pjesë e tyre nuk u denoncuan për shkak të pakënaqësive shumë të mëdha me gjyqësorin në Republikën e Maqedonisë dhe atë me qëndrim negativ me rreth 49.8%.

Këto ishin vetëm disa nga bindjet e qytetarëve për gjyqësorin dhe se kishin shumë ankesa në lidhje me korrupsionin.

#### 4. A keni njohuri rreth gjykimit të drejtë dhe pa vonesë në gjyqësorin e Republikën së Maqedonisë?




**Grafikoni Nr. 4.**

Në pyetjen e katërt: *A keni njohuri rreth gjykimit të drejtë dhe pa vonesë në gjyqësorin e Republikës e Maqedonisë?* të anketuarit lidhur me mënyrën e zgjidhjen e çështjeve juridiko-private kishin mendime të ndara duke i trajtuar çështjet gjyqësore se lëndët apo kontestet zgjidhen drejtë dhe pa vonesë me rreth 25.5%. Ndërsa në nëngrupin e dytë të anketuarit përgjigjeshin në mënyra të ndryshme. Rreth 69.9 % arsyeja e mosbesimit ishte se qytetarët kanë filluar ta humbin besimin në gjykatat vendore për shkaqe se shumë gjatë por edhe me vite nuk vijnë deri tek zgjidhje e të drejtave gjyqësore.

## 5. Ç'mendim keni për rolin e avokatit dhe përmbaruesve?

Pozitiv  
Negativ



**Grafikoni Nr. 5**

Në këtë pyetje të parashtruar nga ana e jonë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë të anketuarit u shprehen të ndarë për sa u përket qëndrimit të tyre për arsye se shërbimet e avokatisë janë shumë të shtrenjta dhe nuk kanë ndonjë tarifë të caktuar pagesore, por megjithatë me rreth 29.4% janë të kënaqur me punën e tyre, ndërsa në grupin e dytë kishin mendime të ndara sepse përmbaruesit funksionojnë vetëm për interesin e tyre por, jo për atë të qytetarëve dhe kishin mendime negative me rreth 69.5% . Kjo ka të bëjë me çështjen e mendimit të të anketuarve që në bazë të mendimit të tyre nuk kishin arritur deri në atë pikë që të kishin ndonjë mendim pozitiv për arsye se në rast se nuk kemi një gjyqësor të suksesshëm funksional nënkupton se të drejtat private me karakter juridiko-civil nuk mund të mbrohen në nivelin e duhur juridik që e parasheh legjislacioni i Republikës së Maqedonisë dhe që bien ndesh me të drejtat dhe konventat ndërkombëtare.

## CONCLUSION

From the terrain data and the comparison of the theoretical and the practical-trial were analyzed and confirmed the set hypothesis and came to this final conclusion based on the methodology of the scientific work, especially for the fundamental rights of the parties dealing with judicial – civil processes and judicial procedural rights in general. This scientific work also is relied on the fact that this topic has not been treated before and thinking it would be valid topic as for the doctrine and for the practice, because the courts have a huge influx of trial lawsuits with disputed civil justice object with private character and what are the concerns of the parties we decided to publish this them on this scientific work. Viewed in this light we are supported and in the opinion of citizens and respondents, we can conclude that and the adequate non-functioning in solving the judicial processes that litigants made even more complicated solution of the disputed issue, because the prolongation of judicial procedural judgments is one of the basic concerns of the parties or of the citizens of the Republic of Macedonia in general when it comes to the judicial system in our country. Therefore the resolution of a civil dispute is important in system of justice rendering, taking into account the position of the parties in the civil legal process is important to develop a fair trial without obstacles. The parties should be informed about the rights that they possess, namely with the rights that legally belongs to them having knowledge of the rights belonging to them, at the same time can protect them. The parties' rights must be guaranteed by the Court, as the court is one that must protect and prevent the abuse of the rights of the parties, in this respect was more lack in information for the rights of citizens by the survey.

Viewed in terms of the functioning of procedural law and that the justice system and even that Macedonia is trying to take important steps for the establishment of the judicial system and further efforts for the consolidation of the justice system are in the above process, in the establishing of the judicial system and judicial institutions it is important to have the commitment and efforts of all stakeholders in society, including academia, to enhance the functioning of the justice system. Access to justice is given and guaranteed to all citizens of the Republic with its legislation in force. In this context, it is suggested that judicial institutions be more updated and respect the court action as provided by legislation, it is enough only adhere to legal rules to be successful as a court and only then the parties will be satisfied with court decisions and



will quell the revolt of litigants. Access to justice is provided and guaranteed to all citizens of the Republic of Macedonia under its legislation in force.

The current legislation contains many laws that foresee equality of all citizens, regardless of ethnicity, gender, age or political belongs on the one hand and on the other hand these laws the citizens do not feel because in practicability do not find justice.

### BIBLIOGRAFIA

1. Bashkim Dr. Selmani “*E Drejta Romake dhe ndikimi i sajë në sistemet e së drejtës bashkëkohore*”, Universiteti shtetëror i Tetovës. Tetovë 2014.
2. Valentina Kondili “*E Drejte Civile. Pjesa e përgjithshme*” Tirane 2007.
3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
4. Brestovci, F. (2006). “*E Drejta Procedurale Civile*”. Prishtine.
5. Zejnulla Gruda “*Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*” (Universiteti i Prishtinës) Prishtinë, 2001 ose botimi i katërt 2007.
6. Caney, Simon and Peter Jones (eds.). 2001. *Human Rights and Global Diversity*. London: Frank Cass Publishers.
7. Bashkim Dr.Selmani, “*E drejta e të drejtave të njeriut*” Universiteti parë Privat FON,-Shkup, 2009.
8. Për një rend publik evropian (Vendime të zgjedhura të Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut, Vëllimi i I 2001, Tiranë)
9. Cassese, Antonio. 2001. *International Criminal Law. A Commentary on the Rome Statute for an Internaitonal Criminal Court*. Oxford: Oxford University Press.
10. Council of Europe (ed.). 2000 (2nd ed.). *Human Rights in Internaitonal Law*, Basic texts. Strasburg: Council of Europe Publishing.
11. Zecchi S. “Njeriu është çfarë ai sheh!”, Sh.B. Spekter, Tiranë 2006.
12. Pango Y. “Psikologjia Sociale”, Sh.B. Korbi, Tiranë 1997.
13. Bardhoshi, N. (2011). “*E Drejta Zakonore*” (cikël leksionesh). Tiranë: UET Press
- Curri, P. (2007). “*Procedura Civile*”. Tiranë: Zara.

14. Ceco, S. (2009). "E Drejta Procedurale". Tiranë: Pegi.
15. Gjata, R. (2008). "E Drejta Procedurale Civile". Tiranë: Dudaj.
16. Kore, D. Sauli, Gj. Zaka, T. (2001). "Disa trajtime teorike dhe praktike mbi Procedurën Civile". Tiranë
17. Lama, V. (2005). "E Drejta e Procedurës Civile". Tiranë: Pegi.
18. Lamani, A. (1961). "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë". Tiranë.
19. Likaj, A. (2009). "Interesi i ligjshëm". Jus&Justicia, 3, 75-88
20. Maho, B. (2011). "Procedure Civile" (Cikël leksionesh). Tiranë: UET Press.
21. Maho, B. (2011). "Profesionet e lira" (Cikël leksionesh). Tiranë: UET Press.
22. Malindi, Y. Ceco, S, Hasani, S. (1986). "E Drejta Procedurale Civile RPSSH". Tiranë Shtëpia botuese e Librit Universitar.
23. Simoni, A. Sadushi, S. Como, S. (2006). "Vështrim krahasues mbi Procedurë Civile". Tirane: Pegi.
24. Tafaj, F. Tushaj, V. (2009). "Padia në drejtësi" (cikël leksionesh). Tiranë.
25. Vasili, J. (2010). "Procedura Civile". Tiranë: Real-stamp.
26. Vokshi, S. (2008). "Procedurë Civile". Tiranë: Frasheri.
27. Mandro Dr. Arta ,, E drejta romake " Emal , Tiranë 2011.
28. Tutulani-Semini , Mariana. E drejta e detyrimeve dhe e kontratave pjesa e përgjithshme dhe e posacme. Tiranë: Skanderbeg Books, 2006.
29. Nerxhivane Dr. Dauti " E Drejta e Detyrimeve" Prishtinë 2004
30. Nuni, Ardian. Mustafa, Ilir. E drejta e detyrimeve Vol. I e II. Tiranë: SHBLU, 2008.
31. Galgano, Francesco. E Drejta private. Tiranë: Luarasi, 2006.

### **Burime plotësuese**

- Bardhoshi, N. (2011). "E Drejta Zakonore" (cikël leksionesh). Tirane: UET Press
- Curri, P. (2007). "Procedura Civile". Tirane: Zara.

- Ceco, S. (2009). “E Drejta Procedurale”. Tirane: Pegi.
- Gjata, R. (2008). “E Drejta Procedurale Civile”. Tirane: Dudaj.
- Kore, D. Sauli, Gj. Zaka, T. (2001). “Disa trajtime teorike dhe praktike mbi Proceduren Civile”. Tirane
- Lama, V. (2005). “E Drejta e Procedurës Civile”. Tirane: Pegi.
- Lamani, A. (1961). “Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë”. Tirane.
- Likaj, A. (2009). “Interesi i ligjshëm”. Jus&Justicia, 3, 75-88
- Maho, B. (2011). “Procedure Civile” (Cikël leksionesh). Tirane: UET Press.
- 26. Vendim Nr. 74, dt.07.10.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- 27. Vendim Nr. 445, dt. 08.06.1999 i Gjykatës së Lartë.
- 28. Vendim Nr. 901 dt. 14.07.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

### **Burime plotësuese**

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

### **SHKURTIMET**

- **Av.** Avokat
- **DHKA-** Dhoma Kombëtare e Avokatisë
- **K.C.-** Kodi civil
- **KE** -Këshilli i Evropës
- **KEDNJ** -Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- **K.Pr.C.** -Kodi i procedurës civile
- **K.Pr.P.** -Kodi i procedurës penale
- **K.Pr.A.-** Kodi i procedurës administrative
- **K.Sh.C.-** Komisioni i shërbimit civil
- **GJEDNJ** -Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- **ZRPP** -Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme